



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:052164

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486423

PPP.nr.13/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në kërkesën e kreditorit KEL E. SH.A, me seli në Ferizaj, rr "...", për përjashtimin e Përmbauesit Privat B.T. nga Ferizaj, më datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET kërkesa e kreditorit KEL E. SH.A, e ushtruar me datë 14.02.2024, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e Përmbauesit Privat B.T. nga Ferizaj, nga zgjidhja e lëndës P.nr.863/20 dhe përjashtohet Përmbauesi Privat B.T. nga zgjidhja e lëndës përmbaimore P.nr.863/20.

A r s y e t i m

Kreditori KEL E. SH.A, me datë 14.02.2024, në këtë gjykatë, ka dorëzuar kërkesën me shkrim, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e Përmbauesit Privat B.T. nga zgjidhja dhe procedimi i lëndës përmbaimore P.nr.863/20, me arsyetimin se duke i shikuar shkeljet e shumta paraprakisht dhe ato në vazhdimësi nga përmbauesi privat, kreditori konsideron se e ka humbur në tërësi besimin e tij dhe se e ka humbur në tërësi kredibilitetin për trajtimin e mëtejme të lëndëve të kreditorit dhe i njëjti ka vepruar njëanshëm dhe në favor të debitorëve.

Përmbauesi Privat B.T., lidhur me kërkesën e kreditorit për përjashtim, ka dhënë deklaratë me shkrim, ku në deklaratën e dhënë me shkrim është pajtuar që të përjashtohet nga kjo lëndë, duke e pas parasysh faktin që kreditori e ka humbur besimin në efikasitetin e veprimeve të përmbauesit privat.

Gjyqtari individual, duke vepruar sipas nenit 17 dhe 325, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 67 dhe 70, të LPK-së, i shqyrtoj shkaqet dhe pretendimet e kreditorit të paraqitura në kërkesën e tij për përjashtimin e përmbaruesit privat B.T. dhe pas analizimit të pretendimeve në kërkesë, vendosi që kërkesën e kreditorit KEL E. SH.A, për përjashtimin e përmbaruesit privat B.T., ta pranoj si të bazuar, nga fakti se nga thëniet e kreditorit në kërkesën për përjashtim dhe nga deklaratat me shkrim e dhënë nga përmbaruesi privat, gjykata ka vërtetuar se kreditori e ka humbur besimin e tij tek veprimet procedurale të përmbaruesit privat në këtë rast dhe konstatoj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 67, pika g), të LPK-së, që të përjashtohet përmbaruesi privat B.T. nga lënda përmbarimore P.nr.863/20, dhe si rrjedhojë vazhdimi i ndërmarrjes së veprimeve tjera përmbarimore në këtë rast nga përmbaruesi privat, vetëm do të shkaktoje humbje edhe më të madhe të besimit të kreditorit tek Përmbaruesi Privat.

Andaj, kjo Gjykatë, duke i marr parasysh të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 17 dhe 325, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 67, pika g) dhe 70, të LPK-së, e pranoj kërkesën e kreditorit dhe e përjashtoj përmbaruesin privat B.T. nga Ferizaj nga zgjidhja e lëndës përmbarimore P.nr.863/20.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.13/24, më datë 21.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është i lejuar kurrfarë mjeti juridik.